



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

DREJTORIA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR

Nr. 2184 prot.

Kopje nr. 1
Tiranë, më 23.10 2017

Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)

Me vendim nr. 2184, datë 11.10.2017, Komisioni i Deklasifikimit dhe i Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror" (KDZH), në DSIK, mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.124, datë 15.3.2001 "Për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror"", vendosi deklasifikimin nga niveli "Konfidencial" dokumentat e mëposhtme:

-Memo nr. 18, datë 10.07.2014, me lëndë "Për zbatimin e kontratës me objekt "Rikonstruksion godine në DSIK"", niveli i klasifikimit "Konfidencial", faqe 5 (pesë).

Përmbajtja e dokumentit:

Kjo memo i adresohet drejtorit të DSIK-së nga ana e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe pasqyron shkurtimisht problematikën e hasur gjatë zbatimit të kontratës me objekt "Rikonstruksion godine në DSIK" nga ana e operatorit ekonomik "Bregu" sha.

Në memo referohet edhe praktika dhe korrespondecia e ndjekur me operatorin ekonomik "Bregu" sha nga DSIK.

-Memo nr. 19, datë 11.07.2014, me lëndë: "Për zbatimin e kontratës me objekt "Rikonstruksion godine në DSIK", niveli i klasifikimit "Konfidencial", faqe 2 (dy).

Përmbajtja e dokumentit:

Kjo memo është vijimi i Memos nr. 19 Prot., datë 11.07.2014, i adresohet drejtorit të DSIK-së nga ana e Drejtorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.

-Memo nr. 49, datë 30.12.2014, me lëndë "Mbi veprimtarinë e Komisionit për marrjen përfundimtare në dorëzim", niveli i klasifikimit "Konfidencial", faqe 2 (dy).

Përmbajtja e dokumentit:

Kjo memo i adresohet drejtorit të DSIK-së nga ana e Kryetarit të Komisionit të ngritur në DSIK dhe informon për mangësitë e konstatuara gjatë rikonstruksionit të godinës dhe marrjes përfundimtare në dorëzim të godinës.

-Memo nr. 540, datë 15.03.2016, me lëndë “Për zbatimin e Urdhrit nr. 99, datë 18.09.2014, “Për marrjen përfundimtare në dorëzim“, niveli i klasifikimit “Konfidencial“, faqe 2 (dy).

Përmbajtja e dokumentit:

Kjo memo i adresohet drejtorit të DSIK-së nga ana e Komisionit “Për marrjen përfundimtare në dorëzim“, i cili në zbatim të urdhrit pasi verifikoi përmbushjen e detyrimeve të sipërmarrësit, ekonomik ka vendosur të mos i zhblllokohet garancia prej 5 % si garanci e punimeve operatorit ekonomik “Bregu“ sha.

-Procesverbal nr. 540/1, datë 15.03.2016, “Për marrjen përfundimtare në dorëzim“ niveli i klasifikimit “Konfidencial“, faqe 7 (shtatë).

Përmbajtja e dokumentit:

Ky Procesverbal është mbajtur nga ana e Komisionit “Për marrjen përfundimtare në dorëzim“ dhe në të pasqyrohet verifikimi i përmbushjes së detyrimeve për korrigjimin e nevojshëm të defekteve gjatë periudhës së garancisë së punimeve.

1.Dosjet u deklasifikuan bazuar në nenin 13, kreu III, të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, i ndryshuar.

2.Arsyeja e deklasifikimit: Interesi shtetëror është më i rëndësishëm se nevoja për ti mbajtur ato të klasifikuara.

DREJTORI

Dorian TOLA